



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 90
Prishtinë, më 27.1.2014, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani Sasha Milosavljeviq, Blerta Deliu–Kodra, Ismet Beqiri, Alma Lama, Glauk Konjufca dhe Albert Kinolli.

Munguan:, Xhavit Haliti Blerim Shala, Fatmir Limaj dhe Suzana Novobërdali

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti

Mbledhjen e kryesoi, Vjosa Osmani, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e dt. 16.12.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për Integritet Evropian për vitin 2013;
4. Shqyrtimi i Planit të punës për vitin 2014;
- 5.. Shqyrtimi i Projektligjit. nr. 04/L-197 për kimikate, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
- 6.. Formimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale;
7. Të ndryshme

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit

Procesverbali u miratua pa vërejtje

3.Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për Integritet Evropian për vitin 2013;

Raporti vjetor i punës së Komisionit u miratua pa vërejtje

4.Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për Integritet Evropian për vitin 2014;

Kryetarja pyeti anëtarët nëse kanë për të shtuar në plan për të qenë sa më i kompletuar dhe mos të ketë nevojë të shtohet pastaj , sepse pjesa më e madhe përveç shqyrtimit të projektligjeve , përfshin raportimin e ministrave.

Hapi debatin duke filluar prej muajit janar.

Glauk Konjufca u ndërlidh duke ngritur çështjen që lidhet mes janarit e shkurtit e që ka të bëjë me raportimin e ministres për Integritet Evropian Vlorë Çitaku lidhur me MSA-në. Pasi që në seancën e fundit ishte shqyrtua kjo çështje , konsideron se është shumë shpejt që në muajin shkurt të ftohet prapë,sepse është thënë krejt dhe nuk ka çka të prezantoj të re.

Kryetarja sqaroi se kur është hartua ky plan nuk kemi qenë në dijeni se do të shqyrtohet në seance, andaj tha kemi dy mundësi :

1.Të shtyhet raportimi për muajin mars ose prill , sepse është e paraparë që ministrja të raportoj çdo tre muaj e jo çdo muaj

2.Ose të ftohet ministrja dhe të raportoj për procesin e liberalizimit të vizave .

Alma Lama u dakordua që të mbetet ashtu siç është paraparë në plan të punës,të ftohet ministrja sepse sa më shumë që raporton ministrja aq më tepër kryhet mbikëqyrja parlamentare dhe për dallim nga seancat plenare ,në komision debatetet po janë më të detajizuara dhe ka shumë çka të debatohet për MSA-në ,procesi i liberalizimit është me shumë interes dhe ka për çka të raportoj.

Blerita Deliu vlerëson se nuk do duhej prapë të ftohet ministrja e të debatohet për çështjen e njejtë pasi që ministrja në seancë ka raportuar për planin e veprimit për MSA-në, para se të kalohet në Komision,për çka edhe Komisioni ka marr vërejtje ,kurse u pajtua të debatohet për liberalizimin e vizave .

Kryetarja tha se deri më tani janë trajtua dhe janë përmbyll 3 kapituj dhe gjithçka është diskutua për çështjen e tregëtis,njëri prej negociatorëve është zv. Ministri i tregëtis dhe industris dhe mund ta ftojme të raportoj për këta tre kapituj.

Pra propozoj që të mbetet për shkurt të raportoj ministrja ,jo për MSA-në, por për liberalizimin e vizave , të dimë se cilat janë ngecjet kryesore në këtë proces.

Sa i përket muajit shkurt **Kryetarja** propozoj të trajtohet çështja e dialogut Kosovë-Serbi,sepse çështja e dialogut është parakusht,për përmbushjen e kriterëve të MSA-së dhe Rezoluta për dialogun që është miratua në Kuvend parasheh involvimin e komisioneve dhe lidhur me këtë propozoj të ftohet Kryeministri Thaqi apo zv.kryeministrja Tahiri të raportojnë në Kuvend.

Alma Lama pajtohet që të ftohen edhe Kryeministri edhe zv.Kryeministri sepse na duhen dy raportet ,politik dhe teknik

Kryetarja tha të konsultohemi edhe me Kryesin e Kuvendit për të ftuar Kryeministrin,nëse ka problem e ftojme zv.kryeministren Tahiri të raportoj,sepse janë arritur dy apo tri marrëveshje e ne nuk jemi në dijeni për përmbajtjen e tyre .

Anëtarët e komisionit u pajtuan me propozimet e kryetares që të përfshihen në Plan.

Sa i përket muajit Mars kryetarja tha se është paraparë të raportoj Ministri i Punëve të Brendshme lidhur me ligjin për Ripranim i cili do ti ndihmoj grupit punues që të dalin me rekomandime.

Blerta Deliu pajtohet të raportoj ministri i PB dhe presin që në muajin mars të dilet me rekomandime lidhur me zbatimin e Ligjit për ripranim ,pas vizitës që ishte bërë aeroportit të Prishtinës dhe në komunën e Mitrovicës për të mësuar për trajtimin dhe vendosjen e të kthyerve.

Për muajin prill nuk kishte propozime shtesë ,anëtarët u pajtuan me pikat e parapara në Plan të punës.

Kurse për muajin Maj ku ishte parapa raportimi i ministrit të punëve të jashtme, **Kryetarja** propozoi që futet në fillim të muajit mars dhe të raportoj lidhur me anëtarësimin në Këshill të Evropës.

Ky propozim u miratua nga anëtarët e komisionit ,u pajtuan që MPJ të raportoj në muajin mars.

Prej muajit qershor deri në dhjetor ,nuk kishte propozime për tu plotësuar apo ndryshuar plani , u miratua si i tillë.

Kryetarja tha se të bashkangjitur e keni edhe Planin vjetor të buxhetit të Komisionit, në këtë plan janë paraqit aktivitetet e komisionit dhe shpenzimet,ku pjesa ma e madhe është parapa për angazhimin e ekspertëve,pikë kjo e cila ka nxjerr problem çdo vit .Ekziston tha një listë me disa

ekspert dhe lus anëtarët e komisionit që deri në fund të javës të paraqesin ekspert të fushave të ndryshme,të zgjerohet lista për 40 ose 50 vet dhe si kriter të jetë,njohurit në fushën e integriteteve dhe ekspertiza në fushën që mbulon dhe listën e plotësuar javën e ardhshme ta miratojmë.

Alma Lama kërkoj që ekspert të vijnë dhe paraqiten vet në komision me sivin e tyre ,kështu që pastaj e kishim bërë përzgjedhjen.

Kryetarja tha se do të kishte qenë mirë,por kjo do të paraqiste problem ,pa biseduar me sekretarin e Kuvendit,sepse nuk është e paraparë kjo formë e paraqitjes.

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Plani Vjetor i punës së Komisionit ,së bashku me Planin vjetor të buxhetit të Komisionit për vitin 2014, u miratuan me propozimet për ndryshim dhe plotësim.

5.Shqyrtimi i Projektligjit. nr. 04/L-197 për kimikate, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Albert Kinolli gjatë raportimit tha se dispozitat e Projektligjit së bashku me amendamentet e komisionit funksional se nuk janë në kundërshtim me dispozitat e BE-së dhe si i tillë mund të procedohet për miratim në Kuvend

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-197 për kimikate, me amendamentet e Komisionit Funksional është në harmoni me Acquis Communautaire.

6.Formimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale

Kryetarja tha se ky është një projektligj jo shumë i mirë dhe se ka pas shumë vërejtje, nëse e monitorojmë zbatimin e tij,mund ti propozojmë vërejtjet tona për ndryshimin e Ligjit,nuk e di se deri ku ka shku ky ligj por e di se është inauguruar një depo, ku do të bëhet ruajtja e pasurisë së konfiskuar, andaj do të duhet ta formojmë një Grup punues për të monitoruar këtë projektligj

Në vazhdim tha se Grupin e pare punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Ripranim jemi pajtuar që ta udhëheq PDK, pastj ligjet tjera LDK,Vetëvendosje e kështu me radhë., tani ky grup punues do të udhëhiqet nga LDK, propozoj Alma Lamën që ta udhëheq,pasi nuk kishte prezent anëtar tjerë nga PDK, propozoj Blerta Deliun, Glauk Konjufcën nga Vetvendosje,kurse nga komunitetet Albert Kinolli, kurse me anëtarin e AAK-së të bisedohet në mbledhjen e ardhshme pasi që nuk ishte prezent.

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri formoj Grupin punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale me këtë përbërje :

Alma Lama udhëheqëse e grupit dhe anëtarët Blerta Deliu, Glauk Konjufca dhe Albert Kinolli. **Kryetarja** kërkoj nga grupi punues i formuar të jetë sa më aktiv dhe deri në fund të javës të bëhet një agjendë e takimeve.

Pasi u mandatua ky komision **Kryetarja** kërkoj nga grupi punues i formuar të jetë sa më aktiv dhe deri në fund të javës të bëhet një agjendë e takimeve dhe të filloj punën menjëherë.

Ismet Beqiri lidhur me këtë ligj tha se të gjithë e dimë ka pas vërejtje të shumta dhe si i tillë nuk është i formuluar mirë dhe nuk siguron që do të ketë sukses në parandalim zbulim dhe dënim e të gjithë akterëve të veprimeve koruptive, sepse nuk ka përmbajtje të mirë, por ky grup punues ka një shans të mirë të tregoj se a po ka rezultate në implementimin e këtij ligji me të gjitha të metat që i ka dhe ky grup me punën e tij të mund të jap edhe sugjerime që në të ardhmen të amendamentohet ky Ligj.

Alma Lama tha se fatkeqësia e këtij Ligji është se përveç zhurmës së madhe që është bërë, përfshirë edhe shoqërinë civile, nuk ka pas asnjë lloj iniciative për ndryshim dhe pa ndonjë ekspert të kësaj fushe, do të përballemi me probleme, sepse synimi i këtij monitorimi është ndryshimi i këtij ligji, është debatuar edhe në shumë shtete sepse është problematike sepse bëhet fjalë për prejardhjen e pasurisë, që tani kërkoj mbështetjen e një eksperti të kësaj fushe që në fund të mundemi me propozua ndryshimet e duhura dhe të garantoj respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit

Kryetarja tha se Komisioni e ka ekspertin që e mbështet komisionin dhe përveç kësaj ka organizata që mëren me këtë fushë dhe në mbledhjen e ardhshme mundemi ti ftojme dhe të shohim sa mundemi me i angazhu .

7. Të ndryshme

Kryetarja në këtë pik kërkoj nga Blerta Deliu që si udhëheqëse e grupit punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Ripranim, të njoftoj për takimet që kanë realizu gjatë monitorimit dhe cilat janë vështërsit në zbatimin e këtij Ligji.

Blerta Deliu theksoi se monitorimi është në përfundim dhe problemi ka qenë se ka mungu një ekspert i fushës për riatdhesim, pas vizitës që ishte bërë aeroportit të Prishtinës dhe në komunën e Mitrovicës për të mësuar për trajtimin dhe vendosjen e të kthyerve, kemi pa se ka probleme në vendosjen e tyre, por problemi më i madh është punësimi i tyre dhe shfrytëzimi i fondeve . Pasi në Mars është caktua një takim me Ministrin e punëve të brendshme ,do të na ndihmoj ta përfundojmë monitorimin dhe të dalim me rekomandime konkrete..

Kryetarja tha se në media kemi pa s disa familje që janë kthyer po ballafaqohen me problemin e strehimit edhe pse esenciale në ligjin për ripranim është sigurimi i strehimit , do të ishte mirë ne si komision të shkojmë dhe ti identifikojmë këto familje dhe të mësojmë për problemet me të cilat ballafaqohen,

Blerta Deliu propozoj që pasi është ndërrua udhëheqja komunale në komunën e Mitrovicës të kërkojmë një takim të dytë me kryetarin e ri të komunës së Mitrovicës dhe të shohim se si po realizohet riatdhesimi, pasi ka qenë e ndarë parcela për të riatdhesuarit,

Në fund të kësaj pike Kryetarja tha se në shumicën e vendeve kur është e intensifikuar agjenda evropiane ,kompetencat e këtij komisioni janë të mëdha ,andaj duhet të kërkojmë,që në Rregulloren e ardhshme të zgjerohen kompetencat në mandatin e këtij Komisioni .

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit

Vjosa Osmani